



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:168899  
Datë: 14.05.2024  
Numri i dokumentit: 05680782

**A.C.nr.1716/21**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Bujar Muzaqi kryetar i kolegjit, Halide Reka dhe Hysni Bardheci, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit M.M. nga fshati P... Komuna e Podujevës, të cilin e përfaqëson me autorizim Z.I., avokat me seli në Komuna Prishtinë, kundër të paditurës Kompania e sigurimeve "E...", me seli në Komuna Prishtinë, në çështjen kontestimore për kompensim të dëmit material dhe jo material, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.442/15 datë 13.01.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 14.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET e pathemeltë**, ankesa e të paditurës Kompania e sigurimeve "E...", me seli në Komuna Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Podujevë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.442/15 datë 13.01.2021, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.442/15 datë 13.01.2021, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

*"... I. APROVOHET PJESËRISHTË SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit M.M. nga fshati P... Komuna e Podujevës dhe DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve "E...", me seli në Prishtinë që paditësit në emër të*

*kompensimit të dëmit material dhe jo material në aksidentin e shkaktuar me datë 13.12.2014, t'ia paguaj shumat e specifikuara si në vijim:*

***Në emër të dëmit jo material:***

- *Për dhimbje trupore-fizike shumën 1300 €*
- *Për frikën e përjetuar shumën 1200 €*
- *Për shëmtim 1000 €*

***Në emër të dëmit material:***

- *Për ndihëm dhe përkujdesjen e personit të huaj shumën 100 €*
- *Për ushqim të përforcuar shumën 150 €*

II. *DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve "E...", me seli në Prishtinë, që paditësit t'ia paguaj kamatën në lartësi pre 8%, për pjesën e aprovuar të kërkesëpadsisë, nga data e marrjes së aktgjykimit 20.01.2021, e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 614.00 €, e të gjitha në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.*

III. *REFUZOHET E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadsisë së paditësit mbi shumat e aprovuara dhe atë: për dhimbjet trupore-fizike shumën 400 €, për frikën e përjetuar shumën 200 €, për shëmtim 500 € për ushqim të përforcuar shumën 150 €, gjithësejt shuma e refuzuar 1250 €...*

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të: zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit në Prishtinë, që ta ndryshojë Aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë ashtu që të gjykoj shumë dukshëm më të vogla se në aktgjykimin .

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe gjeti se:

***- Ankesa e të paditurës, është e pathemeltë.***

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi M.M. nga fshati P... Komuna e Podujevës, me datë 21.09.2015, ka paraqitur padi ndaj të paditurës, Kompania e sigurimeve "E... ", me seli në Komuna Prishtinë, me kërkesë për kompensimin e dëmit material dhe jo material.

Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 13.01.2021, pas dëgjimit të palëve ndërgjyqëse dhe pas administrimit të provave, ka nxjerrë aktgjykim C.nr.442/15 datë 13.01.2021, me të cilin aktgjykim e ka aprovuar

pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit M.M., duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ndër të tjera ka arsyetuar se: *“...pasi bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithë së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK-së, e aprovoj pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nga arsyet si në vijim:, Kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte baza juridike mirëpo kontestuese ishte lartësia e padisë dhe kërkesë padisë, për të cilat përfaqësuesit e palëve ndërgjyqëse kanë paraqitur argumente të ndryshme mes tyre...”*

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e Apelit duke marrë parasysh të gjitha provat e administruara në këtë çështje juridike dhe se nga raporti i policisë i datës 13.12.2014, me numër të rastit 2014-AF-1513, se deri te aksidenti ka ardhur në mënyrë ku vozitësi i veturës “A” xxx , me targa xxx, ishte duke lëvizur nga drejtimi i xxx në drejtim të xxx ku me te arritur në fshatin ..., saktësisht te lagja e quajtur “...”, ka hyr në tejkalim të një traktori –tipit universal i cili kishte qenë duke lëvizur me te njëjtin drejtim para automjetit “A”, ku gjatë tejkalimit drejtuesi në fjalë duke mos e siguruar shiritin e majtë të drejtimit të lëvizjes ndeshet me automjetin “B”-xxx, të cilin e drejtonte M.M. si dhe traktorin të tipit universal të cilin e drejtonte xxx, me ç ‘rast lëndime trupore ka pësuar paditësi dhe po ashtu dëme materiale në veturë, nga kjo rrjedhë edhe e drejta e paditësit dhe detyrimi i të paditurës për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga aksidenti.

Po ashtu edhe e paditura në ankesën e dorëzuar në Gjykatë me datë 12.02.2021 ndër të tjera ka deklaruar se *“E paditura gjatë gjithë procedurës kontestimore nuk e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditëses sa i përket bazës juridike por kontestuese ka qenë lartësia e saj.”*

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, ka vendosur drejtë, pasi që paditësit i takon e drejta në kompensim të dëmit material dhe jo material duke u bazuar në dispozitat e nenit 136,169,174 të Ligji nr. 04/l-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, andaj shumat e gjykuara si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar për paditësin M.M. në emër të dëmit material dhe jo material janë reale duke u bazuar në ekspertizën mjekësore të përpiluar me datë 08.12.2020 nga ekspertet mjekësor M.H. – ortoped – QKUK - Prishtinë dhe psikiatër V.B. QKUK-Prishtinë, ku sipas tyre kanë konstatuar se paditësi M.M.si pasojë e aksidentit të shkaktuar ka pësuar lëndime trupore që cilësohen si lëndime të rënda

trupore, plagë në mjekër, ndrydhje të nofullës së poshtme, ndrydhje koke qafë shpinë dhe gjoksin, të cilës ekspertizë gjykata ia ka falur besimin në tërësi, dhe është detyruar e paditura Kompania e Sigurimeve “E...”, me seli në Komuna Prishtinë, që t’ia paguaj paditësit shumën përmes të cilës ekspertizë edhe gjykata e shkallës së parë ka marrë vendim dhe ka vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit.

Pretendimi ankimor se gjykata e shkallës së parë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, nuk qëndron pasi që dispozitivi i Aktgjykimit është i kuptueshëm, i kjashtë dhe arsytimi i Aktgjykimit përmban të gjitha faktet vendimtare, dhe arsyet pse është vendosë si në dispozitiv të Aktgjykimit.

Pretendimi ankimor i të paditurës lidhur me shpenzimet procedurale, është i pa bazuar, pasi që vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e nenit 452 par. 1 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore.

Pretendimi ankimor i të paditurës se llogaritja e kamatës duhet të bëhet sipas normës së interesit, ky pretendim është i pa bazuar, duke u bazuar edhe në nenin 382.2 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve në të cilin nen ndër të tjera thuhet se “ *Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit...*”.

Gjykata e Apelit i vlerëson si të pa bazuara pretendimet në ankesë të palës së paditur se Gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, sa i përket lartësisë së kompensimit, pasi vlerëson se shumatat e gjykuara nga Gjykata në shkallë të parë, janë reale duke u bazuar edhe në lëndimet e pësura nga paditësi.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore të të paditurës, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 195.1 pika d), e lidhur me nenin 200 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**A.C.nr.1716/21 datë 14.05.2024**

**Kryetari i kolegjit - gjyqtari,**  
**Bujar Muzaqi**